



<b>KMDK SH.A</b>	Dalëse <input type="checkbox"/>
	Hyrëse <input type="checkbox"/>
Nr: <u>552/2017</u>	
Data: <u>31.07.2017</u>	
Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A Kosovo Landfill Management Company J.S.C Kompanija za Upravljanje Deponijama na Kosovu DOO	

Në bazë të nenit 20 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në bazë të nenit 138 të Ligjit Nr. 02-L-123 për Shoqëritë Tregtare, në bazë të nenit 26.23 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, në bazë të nenit 7 të Statutit të Kompanisë, Bordi i Drejtorëve të KMDK SH.A. miraton Rregulloren si më poshtë:

## **RREGULLORE NR. 05/2017 PËR PËRDORIMIN, MANOVRIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E MAKINERIVE TË RËNDA SI DHE TË MAKINERIVE TJERA TË DISPONUESHME NË DEPONITË SANITARE TË KMDK SH.A.**

### **KREU I**

#### **QËLLIMI, OBJEKTI DHE FUSHA E VEPRIMIT**

##### **Neni 1**

Kjo rregullore ka për qëllim vendosjen e bazë rregullative juridike të Kompanisë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A. (në tekstin e mëtejme KMDK SH.A.) sa i përket aktivitetit të administrimit dhe përdorimit të makinerive të rënda, si dhe atyre të lehta dhe të mesme, sipas karakteristikave teknike dhe të sigurisë në punë.

#### **FUSHEVEPRIMTARIA**

##### **Neni 2**

- 1) Kjo rregullore shtrinë fushën e veprimit të sa i përket të gjitha makinerive e disponueshme në deponitë sanitare dhe sektorë tinxhinierik të Kompanisë për Menaxhimin e Deponive SH.A. (me përjashtim të rregullave të lëvizjes në rrugë automobilistike) dhe përcakton:
  - a) Vendosjen e rregullave të administrimit, përdorimit, manovrimit, mirëmbajtjes dhe të lëvizjes së makinerisë së KMDK SH.A.
  - b) Vendosjen e rregullave për aplikimin e aftësive profesionale në operim me makineri, ruajtje, servisim dhe mirëmbajtje të makinerisë.
  - c) Të drejtat dhe obligimet e drejtuesve, masat e sigurisë dhe mbrojtjes gjatë operimit me makineri.
  - d) Procedurat dhe evidencat e parapara sipas udhëzimeve të menaxhmentit të KMDK SH.A. dhe sipas manualeve të makinerisë përkatëse, si dhe
  - e) Veprimet e brendshme të trajtimit, monitorimit dhe kontrollës inspektuese.

#### **EMËRTIMI I DREJTUESVE/MANOVRUESVE**

##### **Neni 3**

- 1) Emërtimet e drejtuesve/manovruesve për Makineritë e rënda inxhinierike, janë si më poshtë:


- a. **ESKAVATORIST**, emërtohet drejtuesi i **makinerisë së gërmimit dhe ngarkimit të dherave**: (*Eskavatorë, makineri gërmuese, lopata ngarkuese, ngarkues të kombinuar me goma dhe zinxhirë*),
- b. **BULDOZERIST**, emërtohet drejtuesi i **makinerisë së gërmimit, transportit, nivelimit dhe të ngjeshjes së dherave dhe mbeturinave**: (*Buldozerë, traktor, skreperë, nivelues(greidera), rulo kompresorë, kompaktorëtë rëndë "Bomag" shtruese asfalto betoni (me goma dhe zinxhirë)*),
- c. **AUTOMAKINIST** emërtohet drejtuesi i **makinerisë së ndërtimit mbi bazë automjeti**: (*Autovinça, autobetoniera, autobetonpompa, autobitumatrice, autosonda*),
- d. **SHOFER** emërtohet drejtuesi i **makinerisë transportuese dhe Kamionëve**(*Përdoruesit e makinerive me rrota gome, përveç lejes së manovrimit duhet të jenë të pajisur detyrimisht edhe me leje drejtimi-patentë shofer*),

## KREU II

### ADMINISTRIMI ME MAKINERI, KOMPETENCAT, OBLIGIMET DHE PËRGJEGJËSITË

#### Neni 4

- 1) Drejtoria e operativës në kuadër të KMDK SH.A është dikasteri përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin në raport me personelin teknik të angazhuar në përdorim të makinerisë si dhe ndaj procedurave operuese në përdorim dhe mirëmbajtje të makinerisë dhe të pajisjeve.
- 2) Drejtoria e operativës në kuadër të KMDK SH.A planifikon, organizon dhe menaxhon punën për mirëmbajtjen dhe riparimin e makinerive në ambientet e veta apo në serviset e specializuara, duke ruajtur gjendjen teknike për punë të sigurt pa defekte dhe pa avari që mund të shkaktojnë aksidente në objektet e punës.
- 3) Drejtoria e Operativës në bashkëpunim me menaxherët e deponisë së caktuar të KMDK SH.A. organizon punën me makineri sipas një plani të hartuar dhe të miratuar prej tyre duke pasur parasysh harmonizimin racional të veprimtarisë operative me kapacitetet teknike, zonat e lëvizjes së manovrimit, thellësitë e gërmimit, këndet e skarpatëve, rrugët e kalimit, distancat nga objektet e ndërtuara, shenjat kufizuese për njerëzit etj.
- 4) Drejtoria e operativës në kuadër të KMDK SH.A, është e obliguar të jap udhëzime së paku një herë në tre muaj mbi rregullat e sigurimit teknik dhe rregullat e shfrytëzimit të makinerive që janë në përdorim.
- 5) Drejtoria e operativës në kuadër të KMDK SH.A, në rast nevojë, analizon dhe planifikon kurse trajnimi si dhe identifikon përmbajtjen e programeve të nevojshme për të avancuar aftësitë profesionale të drejtuesve në raport me karakteristikat funksionale dhe teknike të makinerisë.
- 6) Drejtori i operativës në kuadër të KMDK SH.A në bashkëpunim me inxhinierin e makinerisë, do të përgatisin me shkrim një program i cili përfshinë zbërthimin e sistemeve të makinerisë e posaçërisht të atyre që bartin rrezikshmëri të lartë, po ashtu sa herë që kemi të bëjmë me sistemet e reja hidraulike dhe rregullat e sigurimit teknik në punë dhe në përputhje me manualin e makinës.



- 7) Drejtori i operativës në kuadër të KMDK SH.A. administron dhe mban dokumentacionin e nevojshëm të makinerisë si dhe të gjitha evidencat i raporton me shkrim dhe i arkivon në përputhje me kriteret e përcaktuara mbi arkivin.

## **TË DREJTAT, DETYRAT DHE MËNYRA E PËRDORIMIT TË MAKINERISË**

### **Neni 5**

- 1) E drejta për të përdorur makineritë e rënda inxhinierike, u takon vetëm personave që janë të punësuar me kontratë për të njëjtën veprimtari nga KMDK-ja, dhe të cilët në vazhdimësi dëshmojnë aftësi profesionale.
- 2) Personat drejtues të makinerive e kanë për detyrë të demonstrojnë njohje teorike dhe informacione bazike për funksionimin, destinimin dhe mirëmbajtjen e makinerisë përkatëse si dhe përvojë praktike të mjaftueshme për drejtim dhe operim.
- 3) E drejta për të përdorur makineritë e tjera të mesme dhe të lehta (*të gjitha ato që nuk janë përfshirë në emërtesën e makinerive të rënda*) u jepet stafit teknik i cili ka zhvilluar një kurs teorik dhe praktik të brendshëm nga KMDK SH.A. për makinerinë në fjalë ose pasi të ketë ofruar dëshmi se posedon një dokument për përdorim të tillë.
- 4) Drejtuesit e makinerisë e kanë për detyrë të bëjnë përshtatjen e manovrimit të makinës në raport me kushtet meteorologjike dhe përshkrimeve teknike,
- 5) Me qëllim të uljes së kostos së shpenzimeve dhe të mirëmbajtjes dhe me qëllim të rritjes së efektivitetit, zgjidhen edhe mënyrat e përdorimit dhe të manovrimit.
- 6) Drejtuesi i makinës ka për obligim të furnizojë makinën me derivate, lëndë ftohëse, lubrifikantë, dhe vajra për sistemin motorik dhe hidraulik.
- 7) Drejtuesi i makinerisë ka për detyrë të kujdeset edhe për larjen e makinës dhe sidomos pikat e nryeve lëvizëse, si dhe parandalimin e koordinimit dhe të bllokimit mekanik.

### **KREU III**

## **DETYRIMET NDAJ PËRDORIMIT TË MAKINERIVE DHE ZBATIMI I RREGULLAVE TË SIGURIMIT TEKNIK**

### **Neni 6**

- 1) Personeli inxhiniero-teknik, si dhe manovruesit makinerive, janë të detyruar që para vënies në shfrytëzim të makinerive dhe pajisjeve, të njohin dhe zbatojnë, rregullat e përdorimit, mirëmbajtjes dhe sigurimit teknik të tyre, si dhe të kryejnë provat e plota teknike dhe teknologjike.
- 2) Drejtoria operative e KMDK SH.A. me procesverbal u dorëzon makineritë, vetëm përdoruesve profesionalisht të aftësuar (*ose të pajisur me leje manovrimi*) të cilët shfrytëzojnë, mirëmbajnë dhe përgjigjen për dëmet që shkaktohen për faj të tyre.
- 3) Procesverbali firmoset nga drejtori i operativës, menaxheri i deponisë dhe nga përdoruesi marrës në dorëzim.
- 4) Procesverbali i marrjes në dorëzim të makinerisë dhe leja e manovrimit, janë dokumente teknike që duhet të mbahen detyrimisht nga përdoruesi gjatë gjithë kohës që shfrytëzon makineritë. Procesverbalet paraqiten sa herë që kërkohen nga personat e ngarkuar për kontroll dhe inspektim.
- 5) Përdoruesi çdo ditë para fillimit të punës provon gjendjen teknike të makinerisë duke e vënë atë në lëvizje, në rast se konstaton ndonjë mungesë ose defekt, menjëherë e ndalon makinerinë dhe lajmëron personat përgjegjës.



- 6) Ndalohet fillimi dhe vazhdimi i punës me makineri të defektuar dhe me mungesa teknike.
- 7) Në rastin kur makineria punon me ndërrime, kontrolli i gjendjes teknike të makinerisë bëhet në praninë e dorëzuesit dhe marrësit në dorëzim. Marrësi në dorëzim, në çoftë se bindet se makineria është në gjendje të mirë, fillon punën në të kundërtën lajmëron menjëherë përgjegjës për gjendjen teknike të saj.
- 8) Shënimet mbi gjendjen teknike të makinerisë bëhen në librin e dorëzimit të turnit (ndërrimit), me të cilin pajiset çdo makineri që punon me ndërrime.
- 9) Përdoruesit e makinerive mbajnë përgjegjësi për gjendjen teknike të makinerisë që përdorin dhe duhet të sigurojnë punë me regjim teknik normal, pa avari dhe me siguri të plotë për jetën e tyre dhe të personave të tjerë që punojnë rreth tyre.

### **TRAJNIMET DHE PRAKTIKA**

#### **Neni 7**

- 1) Në rast se në të ardhmen organizohet ndonjë shkollë profesionale për licencim apo certifikim shtetëror për drejtuesit/manovruesit e makinerisë së rëndë, KMDK SHA merr përsipër që, stafin teknik që drejton makina të rënda ta mbështesë në aftësim,
- 2) Personeli i aftësuar me shpenzime të KMDK SH.A është i obliguar që në periudhën një vjeçare pas marrjes së Licencës apo Certifikatës të mbajë kontratë me kompaninë, në të kundërtën, braktisja para afatit të përcaktuar e bartë detyrimin e rikthimit të mjeteve të shpenzuaranë Kompani.
- 3) Trajnimi i drejtuesve dhe automekanikëve mund të parashihet edhe si pjesë e ndonjë kontrate blerëse me prodhuesit e këtyre makinerive sidomos për makineritë e llojeve të reja që kanë të bëjnë me aftësimet dhe testimet për rregullat e përdorimit, mirëmbajtjes dhe sigurimit teknik.

### **KREU IV**

### **VEPRIMET KUNDËRSHTUESE DHE SHKELJA E DETYRAVE TË PUNËS**

#### **Neni 8**

- 1) Për shkeljen e rregullave të administrimit dhe përdorimit të makinerive sipas rastit, jepet përgjegjësi disiplinore, materiale ose penale personit fajtor si dhe personave që kanë urdhëruar të punohet në kundërshtim me rregullat teknike dhe rregullat e sigurimit teknik.
- 2) Përdorimi i makinerive të rënda, pa lejen e manovrimit ose pa përvojën e mjaftueshme përbën dhe ndëshkohet si shkelje e rregullave të sigurimit teknik.
- 3) Në rast se, makineria si rezultat i përdorimit të saj jo të rregullt shkakton avari që shoqërohen edhe me viktima, njoftohet menjëherë organi i prokurorisë dhe merren masat për të ruajtur vendin ku ka ndodhur avaria për të mos bërë ndryshime apo për ruajtjen e provave.
- 4) Përjashtimet nga paragrafi 3). i këtij neni, kanë të bëjnë me rastet kur duhen nxjerrë personat e dëmtuar nga avaria për tu dhënë ndihmën mjekësore si dhe për të likuiduar vatrën që mund të zmadhojë dëmin.
- 5) Për shkeljen e dispozitave të kësaj Rregulloreje, me kërkesë të motivuar nga ana e kontrollës Inspektuese të brendshme të KMDK SH.A. apo të institucioneve dhe të organeve shtetërore, inicohet procedura e marrjes së masave disiplinore.



- 6) Masat e marra i njoftohen personit ndaj të cilit është marrë masa dhe administratës ku ai punon.
- 7) Personi ndaj të cilit është marrë masa përkatëse ndëshkimore, ka të drejtën e ankimit në zyrën për ankesa dhe parashtrës të KMDK SHA-së, brenda 8 (tetë) ditëve, nga data e njoftimit.

## **REFUZIMET**

### **Neni 9**

- 1) Drejtuesi i makinerisë apo automekaniku i servisimit, nuk duhet të zbatojnë asnjë urdhër dhe nuk duhet të marrin asnjë iniciativë për të punuar në kundërshtim me rregullat teknike dhe rregullat e sigurimit teknik.
- 2) Në rastet kur aplikohet refuzimi për shkaqet e cekura në paragrafin 1). të këtij neni, është obligative që arsyeshmëria të jepet me shkrim, duke cekur kriteret specifike të kundërveprimit refuzues.

## **KREU V**

### **MASAT E SIGURISË DHE PAJISJET MBROJTËSE**

#### **Neni 10**

- 1) Personat drejtues të makinerive, duhet të dëshmojnë aftësinë e tyre psiko-fizike me certifikatën shëndetësor me të cilën konfirmohet se fizikisht janë të aftë dhe i përballojnë ambientit të punës.
- 2) Me qëllim të ruajtjes së shëndetit dhe mbrojtjes së imunitetit të organizmit, KMDK-ja u siguron pijet/lëngjet e parapara për kondita të tilla pune.
- 3) Pajisjet mbrojtëse janë obligative për veshje dhe përdorim me qëllim të parandalimit dhe mbrojtjes nga lëndimet fizike, mbrojtjes nga zhurma, pluhuri, si dhe infeksionet tjera të përcaktuara në rregulloren e veçantë “Masat e sigurisë dhe mbrojtjes në punë” si dhe me dispozitat ligjore në fuqi.
- 4) Drejtoria e operativës është përgjegjëse për sigurimin e kushteve sanitare dhe furnizimit me materiale pastruese dhe dezinfektuese.
- 5) Drejtoria e operativës është përgjegjëse për sigurimin e kutisë së ndihmës së parë dhe të aparatit për zjarr fikje.
- 6) Me qëllim të ruajtjes së masës së lëngut dhe të parandalimit të shpërthimeve të mundshme rezervarët e derivateve për tankime duhet të vendosen nën dhe ose mbi dhe por nën konditat e sigurisë dhe të mbahet nën kontroll në përputhje me procedurat e shkarkim-ngarkimit.
- 7) Zonat e rrezikuara përqaasje me makineri, rrethohen me shirit identifikues për rrezikun.

## **KREU VI**

### **SERVISIMI I MAKINERISË MIRËMBAJTJA E TYRE DHE FURNIZIMET**

#### **Neni 11**

- 1) Drejtuesi i makinës përkatëse, automekaniku, autoelektracisti, dhe udhëheqësi i deponisë, janë të obliguar që të kujdesen për mirëmbajtjen e makinerisë sipas manualeve të tyre, apo sipas rekomandimeve të drejtorisë së operativës.



- 2) Mirëmbajtja, servisimi dhe riparimi duhet të jetë i organizuar mirë, me qëllim të parandalimit të defekteve dhe evitimit të humbjeve, duke respektuar afatet e programuara të servisimit si dhe veprimet e menjëhershme aty ku detektohet prishja.
- 3) Drejtuesit e makinerisë, duhet ti përcjellin me kujdes aparturat dhe sistemet e evidentuara si më poshtë:
  - a) Shenjat e instrument-tabelës.
  - b) Sinjalistikën informuese apo alarmuese.
  - c) Pajisjet për startim.
  - d) Orëmatësin e punës, tahografin, si dhe njehsorin e kilometrazhit.
  - e) Sistemin e drejtimit apo komandimit (*pajisjet aktivizimi-çaktivizimi të sistemeve të veçanta gjatë zhvillimit të procesit*).
  - f) Sistemin e frenimit.
  - g) Sistemin hidraulik.
  - h) Sistemin e ndriçimit dhe sinjalizimit të dritave.
  - i) Sistemin e ftohjes (*me ajër apo me lëng*).
  - j) Sistemin lubrifikues dhe të lyerjes.
- 4) Për të gjitha veprimet e ndërmarra në mirëmbajtje dhe servisim, duhet të mbahet evidenca me shkrim (formularët e servisimit, procesvberbalet apo raportet e veçanta),
- 5) Çdonjëra nga makineritë duhet të ketë librin e vet tëservisimi “libri imakinës”.

#### **Neni 12**

- 1) Furnizimi me pjesë rezervë, derivate, vajra dhe materiale të tjera të nevojshme duhet të jetë i bazuar mbi bazën e planifikimit të hartuar nga Drejtoria e Operativës.
- 2) Gjatë procedurave të blerjeve varësisht nga karakteristikat teknike apo teknologjike, produktet duhet të jenë të shoqëruara me dokumente konformiteti, Certifikatë, Deklaratë apo raport testimi si dhe me udhëzues për përdorim.
- 3) Testimi i naftës dhe vajrave, bëhet sipas vlerësimit dhe nevojave të KMDK-së mbi bazën e përcaktuar administrative, procedurale dhe ligjore të përcaktuar nga inspektorati i tregut dhe duke zbatuar procedurat e konformitetit, raportet e testimit në rast jokonformiteti procedohen në organet kompetente, ndërsa në rast konformiteti evidentohen edhe në arkivë.

#### **KREU VII**

#### **LËVIZJET, ZHVENDOSJA DHE TRANSFERIMI I MAKINERISË NGA NJËRA DEPONI NË TJETRËN**

#### **Neni 13**

- 1) Zhvendosja e makinës nga zona e deponisë, apo transferimi i makinës nga njëra depone në tjetrën, bëhet me kërkesë të udhëheqësit të deponisë apo të drejtorit të operativës dhe me miratim të Kryeshefit Ekzekutiv të KMDK SH.A.
- 2) Kërkesa duhet të jetë e arsyetuar mbi bazueshmërinë e nevojës emergjente apo të domosdoshme,
- 3) Faza e transferit dhe e bartjes së makinës, duhet të shoqërohet me procesverbal dhe procedurë të lartë sigurie si dhe me transportues të veçantë për bartje të tillë, duke përforcuar makinën sipas kriterëve të qarkullimit rrugor si dhe duhet të shoqërohet me sinjalistikën e përcaktuar për bartje të tilla.



- 4) Për Kamionët transportues të KMDK-së do të vendoset kontrolli i lëvizjes përmes aparatit (GPRS), i cili do të montohet në secilin automjet.

**KREU VIII**  
**GARAZHAT E MAKINERISË, DEPOT E MAGAZINIMIT DHE ARKIVA E**  
**PJESËVE REZERVË APO TË ATYRE TË NDËRRUARA**

**Neni 14**

- 1) Drejtoria e Operativës dhe udhëheqësit e deponive me qëllim të mirëmbajtjes së deponisë, bëjnë garazhimin e tyre brenda konstruksioneve, me mbuloja për aq sa është e mundur e sidomos në rastet kur makina nuk ashte në përdorim.
- 2) Pajisjet dhe aksesorët si dhe lëndët furnizuese (ujë, lubrifikantë, vajra, aditivë, krepër lyerje etj duhet të mbahen në depo bashkë mbi evidencat për llojin dhe sasinë.
- 3) Kryeshefi Ekzekutiv i KMDK SHA, formon komisionet e pavarur nga personeli i deponisë, për të vlerësuar, verifikuar, për të klasifikuar dhe për të përcaktuar mënyrën e trajtimit të pajisjeve të ndërruara, përfshirë dhe aksesorët dhe mbetjet e ambalazhit.
- 4) Komisioni përgatitë raport me shkrim duke rekomanduar trajtimet specifike dhe të klasifikimit të objekteve të cekura në paragrafin 3) të këtij neni, e të cilat mund të ndahen në:
  - a) Pajisje dhe aparatura për përpunim dhe ripërdorim.
  - b) Mbetje për shitje, dhe
  - c) Mbetje për asgjësim.
- 5) Makineria e amortizuar, paisjet e riparueshme së bashku me mbetjet për shitje, hiqen nga përdorimi dhe ruajtja pasi që ato të jenë vlerësuar nga komisioni i veçantë dhe të njëjtat shiten përmes ankandit publik apo të ndonjë procedurë tjetër të ligjshme për sasi të vogla të mbetjeve për skrap si rezultat i mungesës së depove për ruajtje.
- 6) Komisioni për vlerësim dhe ankand emërohet nga Kryeshefi dhe vepron në pajtim me rregullat e prokurimit.

**KREU IX**  
**KONTROLLA INSPEKTUESE**

**Neni 15**

- 1) Me qëllim të mbarëvajtjes së punëve, ruajtjes së makinerisë dhe në funksion të monitorimit të aktiviteteve, aplikohet kontrolla e brendshme inspektuese.
- 2) Kontrolla inspektuese harton planin mujor (tremujor) të veprimit , si dhe zhvillon inspektimet sipas rastit dhe kërkesave nga KE-ja.
- 3) Kontrolla e brendshme inspektuese, për punën e vet i raporton me shkrim (*duhet të për gatiten formularët e inspektimit*) Kryeshefit Ekzekutiv të KMDK-së.
- 4) Objektivat e kontrollës sipas kësaj rregulloreje janë:
  - a) Gjendja fizike, aftësia profesionale dhe emocionale e drejtuesve.
  - b) Përdorimi i pajisjeve mbrojtëse personale.
  - c) Lokacioni dhe siguria fizike e makinerisë.
  - d) Procesverbali i marrjes në dorëzim të makinerisë dhe (leja e manovrimit).
  - e) Verifikimi i evidencave në raport me aktivitetin e makinës.
  - f) Verifikimin e mirëmbajtjes ditore dhe të asaj periodike.



7

- g) Verifikimin e njehsorëve të punës, kilometrazhit dhe takografët.
- h) Kontrolla e shpenzimeve të lëndëve djegëse dhe vajrave.
- i) Verifikimi i sistemeve të përcaktuara në paragrafin 3). të nenit 11
- j) Verifikon testimin periodik të kualitetit të naftës dhe vajrave.

## **KREU X DISPOZITAT KALIMTARE**

### **Neni 16**

1. Në periudhën 1 vjeçare pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, do të bëhet inventarizimi dhe kodimi i të gjitha makinerive të rënda dhe makinerive të disponueshme në Deponitë Sanitare të KMDK SH.A , si dhe do të vendosen shenjat e sigurisë në përputhje me rregulloren e veçantë për shenjat e sigurisë.
2. Procesi dhe procedura e inventarizimit udhëhiqet nga Departamenti i Administratës përmes një komisioni të veçantë i themeluar me vendim të KE.

## **DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 17**

1. Pjesë përbërëse të kësaj Rregullore janë edhe anekset:
  - Aneksi I: Raporti i humbjes/vjedhjes së makinerisë dhe pjesëve të tjera teknike.
  - Aneksi II: Furnizimet me lëndë djegëse dhe vajra
  - Aneksi III: Fletë dorëzimi - pranimi i makinës
  - Aneksi IV: Raporti i aksidentit/avarisë i cili plotësohet nga drejtuesi i makinës së KMDK-së
  - Aneksi V: Urdhër pune-servisimi
  - Aneksi VI: Hargjimet e derivateve dhe vajrave për Kamionin/Makinën
  - Aneksi VII: Lista e makinerisë së rëndë me të dhënat e nevojshme dhe specifikat e tyre/inventarizimi.
2. Lista e makinerisë me të dhënat e nevojshme dhe specifikat e tyre *(kjo listë azhurnohet varësisht nga shtimi apo zvogëlimi i numrit të makinerisë , dhe azhurnimi mund të bëhet me laps shkrimi duke vendosur datën dhe vulën mbi pjesën e azhurnuar).*
3. Për çdo paqartësi apo konflikt të dispozitave të kësaj rregulloreje, Ligjet në fuqi dhe Statuti i Kompanisë mbizotërojnë mbi këtë rregullore. Në raste të tilla dispozitat përkatëse të kësaj rregulloreje konsiderohen të revokuara, ose ndryshuara në masën e nevojshme për eliminimin e mos përputhjes me ndonjë dispozite të Ligjeve apo Statutit të KMDK-se.

### **Neni 18**

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohen formularët që kanë mbuluar fushën e njëjtë.
2. Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën pasi të jetë miratuar nga Bordi i Drejtorëve dhe të jetë nënshkruar nga ana e Kryesuesit të Bordit të KMDK SH.A.

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve në KMDK SH.A.

Lundrim Camaj

Prishtinë, 31/07/2017











### ANEKSI III FLETE DOREZIM - PRANIMI I MAKINES

Data: \_\_\_\_\_

Flete dorëzim-pranimi plotësohet ne momentin e transferimit te Kamionit/Makinës dhe pajisjeve jo shpenzuese prej një zyrtari te tjetri.

**Shënim:** *Personi i cili pranon pajisjet do te marr përgjegjësinë ne respekt te besueshmërisë, mbajtjes se sigurt dhe mirëmbajtjen e pajisjeve ne mënyrë te duhur. Një kopje e këtij origjinali te nënshkruar duhet te mbahet nga personi i cili e bene dorëzimin e pajisjes dhe ta prezanton atë kur te kërkohet, poashtu Personi i cili e pranon pajisjen duhet te mban një kopje te fletë-dorëzimit për te dhënat e tij ne rast te humbjes, vjedhjes apo demtimit.*

NR	SISTEMET	PO	JO	Targat	PO	JO
1	Shenjat e instrument-tabeles			Çelësat		
2	sinjalistikën e informuese apo alarmuese			Kutia e veglave		
3	Pajisjet për startim,			Kutia e ndihmës se pare		
4	Orëmatësin e punës,			Aparat për zjarrfikje		
5	Takografin, si dhe njehsori i kilometrazhit			Rrota rezerve		
6	Sistemin i drejtimit			Zingjire rezerve		
7	Sistem i komandimit			Kabell shartuese		
8	<i>pajisjet aktivizimi-çaktivizimi të sistemeve të veçantë</i>			Litarë te çelike për tërheqje		
9	Sistemin e frenimit			Lloz statik për tërheqje		
10	Sistemin hidraulik			Mjete te tjera, Kazme, çekiç, dalta		
11	Sistemin e ndriçimit dhe sinjalizimit te dritave			Lidhëse te zingjireve		
12	Sistemin e ftohjes ( <i>me ajër apo me lëng</i> )			Lopate		
13	Sistemin lubrifikues dhe te lyerjes			Gërryese te bores/akullit		
14	Mbajtësi i dokumenteve					
15	Raporti i aksidentit/avarisë					
16	Kartela e mirëmbajtjes					
Përshkrimi i demit:						
<b>Me rendësi:</b> Ky dokument duhet t'i dergohet personit përgjegjës/Zyrtarit  Para çdo pranim - dorëzim te automjetit zyrtare inspektoni automjetin, pasi ta keni inspektuar kjo formohet duhet te nënshkruhet nga te dy palët				Kopja e kartelës se identifikimi te personit i cili e pranon automjetin zyrtare		
Dorezuesi, Nr.ID: _____ Emri: _____ Dept/Spektori: _____ Tel: _____ Nenshkrimi: _____ Data: _____				Pranuesi, Nr.ID: _____ Emri: _____ Dept/Spektori: _____ Tel: _____ Nenshkrimi: _____ Data: _____		



**ANEKSI IV**

**RAPORTI I AKSIDENTIT/AVARISE I CILIT PLOTESOHET NGA DREJTUESI I MAKINERISE SE KMDK-ës**

Data: \_\_\_\_\_

Nr. Referencës te rastit \_\_\_\_\_

Shënimet e Drejtuesit te makinerisë \_\_\_\_\_

Emri: \_\_\_\_\_ Ngarkim funksioni: \_\_\_\_\_

Nr i ID: \_\_\_\_\_ Nacionaliteti \_\_\_\_\_

Targat \_\_\_\_\_ Nr. i ID \_\_\_\_\_

Tipi i makinerisë \_\_\_\_\_ Fund i detyrës: \_\_\_\_\_

Viti i makine: \_\_\_\_\_ kushtet klimatike: \_\_\_\_\_

Sektori/Divizioni \_\_\_\_\_

Nr.i Tel: \_\_\_\_\_ Lokacioni i zyrës \_\_\_\_\_

Dëmet: \_\_\_\_\_

Lendimet \_\_\_\_\_

Mjeku/Spitali: \_\_\_\_\_

Pjesëmarrës te tjerë: \_\_\_\_\_

Nr. serik i autorizimit \_\_\_\_\_

**Raporti i**

**Aksidentit/avarise** \_\_\_\_\_

Data e aksidentit: \_\_\_\_\_ Koha: \_\_\_\_\_

Komuna ku ka ndodhur aksidenti \_\_\_\_\_ Lokacioni \_\_\_\_\_

Raportuar ne stacionin policor ne \_\_\_\_\_ Nr. i tel. te stacionit policor \_\_\_\_\_

Emri zyrtarit policor \_\_\_\_\_ Nr. i ID. se zyrtarit policor \_\_\_\_\_

**PËRSHKRIMI I DETAJEVE** (poashtu veprimet e marra dhe skicimet në detaje, nëse duhet shtohen flete tjera)

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_







### ANEKSI VI

Harxhimet e derivateve dhe vajrave për Kamionin/Makinë \_\_\_\_\_

Muaji \_\_\_\_\_ Viti \_\_\_\_\_

Data	Orët e fillimit /Nr. njësorit para nisjes	Orët e mbarimit /Nr. njësorit pas kthimit	Orë pune/km	Naftë, sasia e litrave	VAJI	Vaj transmisioni	Hidroli	Yndyr	A.friz	Ad Blue	Vërejtje
					Lloji I vajit/sasia	Lloji/sasia	lloji				
1											
2											
3											
4											
5											
6											
7											
8											
9											
10											
11											
12											
13											
14											
15											
16											
17											
18											
19											
20											
21											
22											
23											
24											
25											
26											
27											
28											
29											
30											
31											



**ANEKSI VII**  
**LISTA MAKINERISË SË RËNDË ME TË DHËNAT E NEVOJSHME DHE**  
**SPECIFIKAT E TYRE/INVENTARIZIMI**

Nr	Makineria e rëndë:	Tipi	Sasia në copë	Viti i prodh.	Lënda djegës e	Pesha Ton	Vendi ( DS )	Vërejtje/shënime
1	KOMPAKTOR ËT	BOMAG BC 672 RB	1	2002	Diesel	32	Prishtinë	
		BOMAG BC 672 RB	1			32	Prizren	
		BOMAG BC 672 RB	1			32	Gjilan	
2	BULDOZERËT ( ME ZINGJIRË )	FIAT HITACHI FL 175	1	2001	Diesel	18	Prizren	
		FIAT HITACHI FL 175	1	2001		18	Gjilan	
		DRESSTA TD 15 M EXTRA	1	2010		20	Gjilan	
		LIU GONG CLGB230R	1	2014		24	Prizren	
		KOMATSU D31 S16	1	1978	7	Ferizaj		
		LIEBHERR 734	1	2012	Diesel	22.8	Prishtinë	
3	NGARKUES	SKIP FERMEC 960	1	2002	Diesel	8	Ferizaj	
4	KAMIONËT	Iveco MP 260 E 44 H	1	2005	Diesel	12.6	Ferizaj	
		Iveco Trakker	1	2011		13.8	Ferizaj	
		Ford Cargo	1	2008		9.7	Ferizaj	
		Ford CDL1 cargo 3536D	1	2014		9.68	Ferizaj	
5	RIMORKIOT E KAMIONËVE	ITR 26	1	2005	-	5.7	Ferizaj	
		Rimorkio	1	-	-	-	Prishtinë	
6	MINI KOMPAKTOR Ë	Bomag BW 6S	1	2003	-	-	Gjilan	
		Bomag BW 6S	1	2003	-	-	Podujevë	
7	Të tjera							

*Ps. Kjo listë azhurnohet varësisht nga shtimi apo zvogëlimi i numrit të makinave, dhe azhurnimi mund të bëhet me laps shkrimi duke vulosur me datë mbi pjesën e azhurnuar*

Nr	Rezervuarët	Kapaciteti në litra	Sasia në copë	Lënda djegëse	Vendi ( DS )	Vërejtje/shënime
1	Rezervuar i naftës	5000	1	Diesel	Prishtinë	
2	Rezervuar i naftës	5000	1	Diesel	Prizren	
3	Rezervuar i naftës	5000	1	Diesel	Gjilan	
4	Rezervuar i naftës	2000	1	Diesel	Podujevë	

*Ps. Kjo listë azhurnohet varësisht nga shtimi apo zvogëlimi i numrit të rezervuarëve dhe azhurnimi mund të bëhet me laps shkrimi duke vulosur me datë mbi pjesën e azhurnuar*

Nr	Gjeneratorët	Sasia në copë	Lënda djegëse	Vendi ( DS )	Vërejtje/shënime
1	Gjenerator prej 110 kw	1	Diesel	Prishtinë	
2	Gjenerator prej 110 kw	1	Diesel	Prizren	
3	Gjenerator prej 110 kw	2	Diesel	Podujevë	
4	Gjenerator 70 kw	1	Diesel	Prizren	
5	Gjenerator 60 kw	1	Diesel	Gjilan	
6	Gjenerator prej 16 kw	1	Diesel	Ferizaj	
7	Gjenerator prej 2.5 kw	1	Diesel	Gjilan	

*Ps. Kjo liste azhurnohet varësisht nga shtimi apo zvogëlimi i numrit të gjeneratorëve, dhe azhurnimi mund të bëhet me laps shkrimi duke vulosur me datë mbi pjesën e azhurnuar*

Nr	Pompë e ujërave të zeza ricirkuluese	Sasia në copë	Fuqia/Lënda djegëse (me rryme)	Vendi ( DS )	Vërejtje/shënime
1	Pompë	3	55KW 2x24KW	Prizren	
2	Pompë	3	55KW 24KW 18KW	Gjilan	
3	Pompë	2	24KW 18KW	Podujevë	
4	Pompë Mobile	1	1.1KW	Prishtinë	
5	Pompë Raketë	1	0.25KW	Prizren	
6	Pompë Raketë	1	0.25KW	Gjilan	

*Ps. Kjo liste azhurnohet varësisht nga shtimi apo zvogëlimi i numrit të pompave ricirkuluese, dhe azhurnimi mund të bëhet me laps shkrimi duke vulosur me datë mbi pjesën e azhurnuar*

Nr	Pajisjet e tjera teknike te disponueshme	Sasia në copë	Kapaciteti i matjes (ton)	Vendi/( DS )	Vërejtje/shënime
1	Peshore dixhitale	1	40	Prishtinë	
2	Peshore dixhitale	1	40	Prizren	
3	Peshore dixhitale	1	40	Gjilan	
4	Peshore mekanike	1	40	Podujevë	
5	Peshore mekanike	1	40	Ferizaj	

*Ps. Kjo liste azhurnohet varësisht nga shtimi apo zvogëlimi i numrit të Pajisjet e tjera teknike te disponueshme, dhe azhurnimi mund të bëhet me laps shkrimi duke vulosur me datë mbi pjesën e azhurnuar*